



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA VLORË
KËSHILLI I BASHKISË

Nr _____ prot

Vlorë, më ____ . ____ 2023

Procesverbal

Nr 11, datë 31.08.2023

I mbledhjes së këshillit të bashkisë, e cila zhvillohet në sallën e mbledhjeve në Pallatin e Kulturës “Labëria”(Ora 10⁰⁰)

Marrin pjesë :

- | | |
|---------------------|----------------------|
| 1.Sokol Kushta | 24.Liri Dëma |
| 2.Simo Petromilo | 25.Dikens Bushaj |
| 3.Vullnet Bilbilaj | 26.Erëmal Arapi |
| 4.Gjergji Nika | 27.Elpiniqi Mërkuri |
| 5.Edison Kapaj | 28.Anisa Ceno |
| 6.Jerina Dervishaj | 29.Frosina Qyrdeti |
| 7.Evis Allushi | 30.Vjola Xhafaj |
| 8.Rajmonda Zoto | 31.Ledia Sholla |
| 9.Brikena Puka | 32.Englantina Imeraj |
| 10.Marsela Dashi | 33.Besmir Brahimi |
| 11.Illir Aliaj | 34.Edlira Kapllanaj |
| 12.Myzafer Elezi | 35.Grigor Dede |
| 13.Endri Hyseni | 36.Roland Strakosha |
| 14.Ardian Musta | 37.Lorel Canaj |
| 15.Eglantina Aliaj | 38.Elca Bezhani |
| 16.Mujo Shakaj | 39.Arsen Belaj |
| 17.Atird Hoxha | 40.Alta Haluci |
| 18.Klodian Xhyheri | 41.Refie Laze |
| 19.Novrus Rrokaj | 42.Eda Begaj |
| 20.Liljana Breshani | 43.Geron Gunbardhi |
| 21.Ervis Moçka | 44.Gëzim Çapoj |
| 22.Brikena Sika | 45.Briseida Çakërri |
| 23.Aurora Qarri | 46.Eneida Vera |

Mungojnë :

- 1.Simbol Pazaj
- 2.Shkëlqim Leskaj
- 3.Arjan Isufi
- 4.Anxhela Shenaj
- 5.Bujar Osmanaj



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA VLORË
KËSHILLI I BASHKISË

Nr _____ prot

Vlorë, më ____ . ____ 2023

Procesverbal
Nr 11/1, datë 31.08.2023

Znj.Elpiniqi Mërkuri – Përhëndetje të gjithëve !

Të nderuar Këshilltarë!

I nderuar Kryetar i bashkisë!

Meqenëse kemi numrin për zhvillimin e mbledhjes, fillojmë me shprehjen e ligjshmërisë.

(Lexon , shkresat e ardhura nga prefekti i qarkut)

Nga institucioni i Prefektit të Qarkut Vlorë, vendimet e këshillit bashkiak Nr 56÷ 59, janë shprehur të ligjshëm,(me shkresën e parë) dhe me shkresën e dytë, vendimet e këshillit bashkiak Nr 60 ÷ 62, janë shpallur të ligjshëm.

Vijojmë me rendin e ditës. Ka pyetje apo diskutime ?

Z.Atird Hoxha – Përsa i përket rendit të ditës, është në kundërshtim me rregulloren, neni 65,pika 2, ku rendi i ditës s’duhet të jetë me më shumë se 10 projektvendime. Jeni në kundërshtim me rregulloren, nenin 65 të saj, pra, të tërhiqen kryetarët e grupeve dhe të vendosin ose numrin 10 të projektvendimeve ose 5 projektvendimendërsa për shprehjen e ligjshmërisë, si e ka dhënë prefekti... Bashkia Himarë , nuk e ka dhënë miratimin.

Z.Daut Zëraj – Në lidhje me rendin e ditës, janë 4 projektvendime me të njëjtin objekt, djegie banesash si dhe, 4 pikat e fundit, janë proceduriale, për komisionet. Mendoj se, nuk ka shkelje të procedurës.

Z.Atird Hoxha – Nuk jeni mbështetur në rregullore. Po citoj nenin 65 (lexon.....nuk citon objektin..Në pikën 9, kemi projektvendimin për shtyrjen e aftit të kontratës që, ka dhënie me konçension...

- Jo , nuk është konçension.

Z.Atird Hoxha – Kemi 14 projektvendime, jeni në shkelje të rregullores.

Z.Ervis Moçka – Konferenca e kryetarëve është mbledhur dhe, ka miratuar këtë rend dite. Pra, janë 4 projektvendime dhe, mund të vendosen në 1 të vetëm, meqenëse kanë të njëjtin objekt,

dëmshpërblim banesash. Dua mirëkuptimin tuaj. Pra, s'mund të heqim 3 dhe të lëmë 1 për djegie banese....dhe kryetari i grupit tuaj ka miratuar këtë rend dite.

Znj.Elpinqi Mërkuri – E hedhim në votim?

Pro – 38 vota

Kundër – 7 vota

Abstenim – 0 vota

Miratohet rendi i ditës.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA VLORË
KËSHILLI I BASHKISË

Nr _____ prot

Vlorë, më ____ . ____ 2023

Procesverbal
Nr 11/2, datë 31.08.2023.

Znj.Elpiniqi Mërkuri – Kalojmë në pikën e parë të rendit të ditës, në miratimin e procesverbalit të mbledhjes së datës 31 korrik 2023.

Z.Klodian Xhyheri – Ju duhet të sistemoni vendet e “Bashkë Fitojmë” , jemi grupi më i madh opozitar.

Së dyti, bazuar në Nenin 80 të Rregullores së këshillit bashkiak, për procedurat e votimit të hapur...(Lexon)..., në lidhje me procedurën e votimit....Pas çdo votimi, duhet të citojmë projektvendimin përkatës dhe rezultatin.

Znj.Elpiniqi Mërkuri – Kalojmë në pikën 1 të rendit të ditës.

Ta hedhim në votim?

Votohet.

Pro – 39 vota

Kundër – 0 vota

Abstenim – 0 vota.

Miratohet.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA VLORË
KËSHILLI I BASHKISË

Nr _____ prot

Vlorë, më ____ . ____ 2023

Procesverbal

Nr 11/3, datë 31.08.2023.

Znj.Elpinqi Mërkuri – Pika 2 e rendit të ditës, miratimi i projektvendimit “Për dhënien e ndihmës ekonomike nga të ardhurat e bashkisë, për muajin korrik 2023” .

Një relacion nga administrata.

Znj.Irena Stasa/DNSHS - Si zakonisht, Drejtoria e Ndhmës Ekonomike , përgatit 2 projektvendime, nga të ardhurat e bashkisë dhe nga fondi i kushtëzuar. Nga të ardhurat e bashkisë , përfitojnë 30 familje, e ndarë kjo në bashki dhe njësi administrative .

Të mos trajtohet me ndihmë nga të ardhurat e bashkisë, është 1 familje.

Të trajtohet për herë të parë me ndihmë ekonomike, me të ardhurat e bashkisë, 1 familje. Zonja , nuk është hedhur në skedën e ndihmës ekonomike . Në riaplikim, në sistem, ka bërë ankesë.

Kemi punonjës mbështetës, grup pune Zonja në fjalë është kryefamiljare.Për arsye objektive , ne e trajtojmë me të ardhurat e bashkisë.

Z.Endri Hyseni – U mblodh komisioni juridik, pika 2, bazuar në ligj, është në përputhje me legjislacionin në fuqi....., por neni 55, pika 6, të citohet.

Ftoj të gjithë ta mbështesim dhe votojmë këtë projektvendim.

Z.Klodian Xhyheri - Për ndihmë ekonomike, për 1 familje, të ardhurat janë qesharake. Nëqoftëse, do japim kontributin tonë, mendoj, të bëjmë një grup, ti bëjmë një kërkesë parlamentit, Këshillit të ministrave, që të rritet kjo vlerë.

Z.Ervis Moçka – Është hera e dytë që, zgjatemi të bëjmë politikë të madhe. Të dyja palët kemi përfaqësues në parlament. Ne jemi këtu për të miratuar këtë ndihmë ekonomike, për këto familje që kanë paraqitur kërkesë.

Z.Klodian Xhyheri – Le, ta fillojmë që nga ne, parlamenti i vogël.

Z.Ervis Moçka – Le ta fillojmë me miratimin

Znj.Elpinqi Mërkuri – E kalojmë në votim.

Pro – 45 vota

Kundër – 0 vota

Abstenim – 0 vota

Miratohet.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA VLORË
KËSHILLI I BASHKISË

Nr _____ prot

Vlorë, më ____ . ____ 2023

Procesverbal
Nr 11/4, datë 31.08.2023.

Znj.Elpinqi Mërkuri - Pika 3 e rendit të ditës, miratimi i projektvendimit “Për dhënien e ndihmës ekonomike nga fondi i kushtëzuar , për muajin korrik 2023”. Një relacion ?

Znj.Irena Stasa – Është fondi i qeversisë 6%. Janë 15 familje përfituese nga fondi i kushtëzuar. Administratoret bëjnë rakordimet në sistem. Janë 15 familje për një vit rresht.

Z.Endri Hyseni – Le ti japim votën pro, miratimit të këtij projektvendimi.

Znj.Elpinqi Mërkuri – Votohet.

Pro – 45 vota

Kundër – 0 vota

Abstenim – 0 vota

Miratohet.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA VLORË
KËSHILLI I BASHKISË

Nr _____ prot

Vlorë, më ____ . ____ 2023

Procesverbal
Nr 11/5, datë 31.08.2023.

Znj.Elpinqi Mërkuri – Pika 4 e rendit të ditës. Miratimi i projektvendimit “ Për një rishpërndarje të fondit të investimeve të parashikuar në VKB Nr 1, datë 18.01.2023, për Buxhetin e Bashkisë Vlorë, për vitin 2023, i ndryshuar”. Një relacion.

Z.Hiqmet Haxhaj /DFBK – Në lidhje me këtë projektvendim, kërkohet ndërtimi i zyrës me një ndalesë , për ofrimin e shërbimit të qytetarëve.Është menduar të ndërtohet zyra me një ndalesë, ku shërbimin qytetari ta marrë menjëherë nga administrata. Kemi përdorur fondet e kursyera . Shuma është 8 milion 892 mijë lekë...do merren nga projekti për asfaltimin e rrugëve....Kjo zyrë përfshin ndërtimin, mobilimin, rrjetin dixhital etj.. Me vënien në zbatim të kësaj zyre, qytetarët do të marrin shërbime. Kemi lëvizje, nga një zë në zërin tjetër.

Znj.Elca Bezhani – Projektvendimi nr 4, ndërtimi i zyrës” One Stop Shop”, bazuar në ligjin Nr 135/2015. Përveç relacionit që ne e këshilluam , komisionit i’u paraqit projekti dhe preventivi i kësaj zyre. Bashkia Vlorë është nga të fundit, që nuk e ka këtë zyrë. Komisioni e pa si të domosdoshme ndërtimin e kësaj zyre .

Z.Atird Hoxha – Pjesa teknike duhet të paraqitet, jo do bëhet më mirë, apo më keq.

Këto fonde, nga u kursyen dhe si ?

Në momentin që do të ketë diskutime të tilla, zonja kryetare, ndërpriti këto diskutime...One Stop Shop, ju po hapni sportele...Nëqoftëse, është në të mirë të qytetarëve, le të bëhet....

Zoti Kryetar!

Janë ngritur disa zyra në lidhje me informimin për turistët...Jepen fonde, lekë...Të dijmë sa punojnë, rezultatet ..etj

Z.Ermal Dredha/Kryetar i Bashkisë – Zyrat e Info point..do të ketë një rrjet të gjerë. S’kam statistika të sakta, sa kanë marrë shërbim...Përsa i përket One Stop Shop-it, është shumë e domosdoshme. Është për tu parë performanca gjatë rrugës. Është institucioni i parë, është për ti shërbyer komunitetit.

Është një derë në godinë, ku hyjnë të gjithë, kemi shërbime dhe për çertifikata ... Kemi menduar zyrën One Stop Shop, duam të bëjmë dhe një pjesë rregullatori....Duam të masim dhe

performancën e punonjësve në bashki. Mendoj se, është e domosdoshme, do tu shërbehet qytetarëve. Besoj që, nuk ka gjë të madhe për të diskutuar. Përfitimi i vetëm, është qytetari, jo i yni. Nga ana teknike

Z.Klodian Xhyheri – Fondi 8 milion 892 mijë lekë, është kursyer nga rehabilitimi, asfaltimi i rrugëve...pra në 5 rajonet e Vlorës. Unë kam një rrugë tek shtëpia..ish Fabrika e Tullave , ka shumë vite pa u vënë dorë. Jam pak skeptik për One Stop Shop-in. Nuk e di si do funksionojë. Më duket shumë ironike që, të përballohet nga ky fond, t’u hiqet rehabilitimit, asfaltimit të rrugëveKu u kursyen këto lekë? Tek shkolla “Halim Xhelo “, rruga është alarmante. Kemi shumë nevojë për të bërë këto rrugë, po pikërisht asfaltit i’ a hoqët për të bërë zyrën ?

Z.Gjergji Nika - Menodj që, ky projektvendim, të lihet për mbledhjen tjetër. Bashkia në 8 vjet, ka qenë efiçente vetëm në muajt maj...Nuk çalon problemi tek zyra . Nëqoftëse, kemi fonde të kursyera 8 milion e 892 mijë lekë...Pra, pse kalon fondi nga financimi me këtë fond për të bërë preventiva me këtë vlerë.... Për mua, hyrja mund të bëhet nga hyrja e bashkisë. Por, ju nuk mund të prishni strukturën, prishët ngjyrën dhe tani mund të prishni dhe hapni derën...Zyra ta ketë hyrjen nga Zyra , rikonstruksioni i zyrës 8 milion lekë dhe diskutojmë vlerën e fondit , si mund të hedhim në këtë zyrë 12 milion lekë në tavanë, kur Të shikojmë dhe një herë projektin Hyrja të bëhet nga përpara. Shikoni dhe një herë preventivin, është shumë i fryrë. Ne kemi bërë shumë pa këtë zyrë...Le të presim dhe 1 muaj, të shihet preventivi...Problemi është që, ju në çdo aspekt , shikoni pjesën e projektit. Mendoj që, ta shtyni , të shikoni projektin. Jo të prishet pjesa e strukturës nga brenda , të punohet, të shihet pjesa e mureve.

Z.Ermal Dredha - Janë ndjekur disa faza. Ju paragjykoni, thoni që, e bëmë projektin me sa lekë kishim, Kjo ka të bëjë me atë funksion..Hyjnë qytetarët. Interesi, ky ishte i pari. Pasi është bërë projekti , jemi konsultuar me Institutin e Monumenteve, këtu në këshill dhe më vonë në Ministrinë e Kulturës. Janë arkitektë , e kanë studiuar.

Z.Gjergji Nika – Ideja është që, ajo nuk është funksionale apo prishen lekë... Ajo, meqenëse do vendosni të hapni derën, hapeni të paktën 5 m. Do të hyjnë në derën kryesore dhe do shkojnë majtas. Janë po ata njerëz . Kështu si po shkojnë gjërat, ju po vazhdoni gabimin e atij të parit. Mos t’ia ndryshojmë identitetin strukturës.

Z.Ermal Dredha – Bashkia, nuk kemi lënë në harresë gjërat e tjera. Ja, u shty dhe 1 muaj, çfarë ndryshimi ka ? Nuk qëndron këtu problemi...Hajd të diskutojmë, të marrim arkitektët. Ne nuk jemi arkitektë.

Z.Gjergji Nika – Diskutojmë pjesën vizive, ku e shohim. Çfarë shkon dhe çfarë , jo.

Z.Ermal Dredha – Do ta çojmë dhe në Ministrinë e Kulturës. Është një grup që kanë punuar. I kërkova , zyrës së urbanistikës që, duhet kjo zyrë. Gjithmonë, ka ndërhyrje në godinë. Pjesën teknike, arkitekti nuk e merr përsipër.

Z.Gjergji Nika – Sa vende, sa karrige keni....Bëjeni 10 m , fasadën.

Z.Ermal Dredha – Vijnë qytetarë, të trajtohen si njerëz, jo në turma. Të bëhet zyra dhe, të ofrohet shërbim.

Z.Ervis Moçka – Shumë nga këto shqetësime, mund ti kenë dhe këshilltarët. Mund të ngrejmë shumë probleme , ka çështje teknike. Sensi i projektvendimit është që ti ofrohet shërbim shumë i mirë qytetarit. Anëtarët e opozitës e pranojnë këtë zyrë, por ka probleme teknike. Është e kotë që humbasim kohë. Ta kalojmë këtë projektvendim, pastaj do të kalojë në disa faza të tjera.

Z.Geron Gunbardhi – Zoti Gjergji, nuk ishte dje në mbledhje. Ne në komision vendosëm që kjo zyrë të bëhet. Parimisht, shumë projekte që janë në të mirë të qytetarit, ne jemi dakort . Ne të shohim, drejtorja e urbanistikës ta shohë, ta miratojmë dhe le të shohim në

Znj.Elpinqi Mërkuri – E hedhim në votim.

Pro – 42 vota

Kundër – 1 votë

Abstenim – 3 vota

Miratohet.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA VLORË
KËSHILLI I BASHKISË

Nr _____ prot

Vlorë, më ____ . ____ 2023

Procesverbal
Nr 11/6, datë 31.08.2023.

Znj.Elpinqi Mërkuri – Pika 5 e rendit të ditës, miratimi i projektvendimit “Për miratimin e vlerës financiare të dëmeve të shkaktuara nga djegia e banesës të z.Petrit Izetaj, në datën 29.04.2023 dhe, shpërblimin financiar nga ana e Bashkisë Vlorë”.

Z.Aulon Spaho /DMC – Bazuar në VKM Nr 329, për dhënien e ndihmës financiare, në raste fatkeqësish(djegje banese). Janë bërë preventivat, janë të përcaktuara dhe vlerat financiare. Janë 4 banesa të djegura, z.Petrit Izetaj, z.Besnik Çobo, znj.Anife Aliraj dhe z.Gjergji Memaj.

Z.Erëmal Arapi – Jemi dakort, por kur keni shkuar në këto vende, duhet të bashkëlidhni dhe procesverbalin dhe, kanë vlera të ndryshme.

Z.Geron Gunbardhi – Zoti Gjergji Memaj, do të ishte mirë dhe procesverbali, vlerat janë të ulëta...të kishin dhe procesverbalin..Zoti Gjergji le të hiqet këtë herë dhe të shtohet vlera, herën tjetër.

Znj.Elca Bezhani – Për projektvendimet Nr 5,6,7 i diskutuam në komision, bashkë me relacionet. Proceverbalet janë në bashki dhe, përsa i përket diskutimit të zotit Geron, në lidhje me zotin Gjergji, vlera ishte e pamjaftueshme, por diskutuam me zotin Aulon , por këto bazuar në

Z.Illir Aliaj – Procesverbali kur digjet banesa , ngrihet një komision, mbahet një procesverbal dhe pasqyrohet me foto. Është mbajtur procesverbali dhe foto nga MKZ dhe firmoset kërkesa nga qytetari.Ka qytetarë që, kur s’janë dakort me vlerën në procesverbal, nuk firmosin. Kështu që, këta kanë firmosur , nuk kanë pas kundërshtime.

Z.Atird Hoxha – Të katër këto projektvendime, kanë të përcaktuar vlerën...,për orenditë..etj Sa është në m2 dëmi? Sa orendi ...? Nuk jam dakort me zotin Aliaj që thotë... Pra, dhe unë mendoj që të ishte procesverbali në m2 të djegur dhe orenditë e dëmtuara. Këta qytetarë , nuk e kanë idenë çfarë vlere financiare marrin. Jam i mendimit ti tërheqin këto materiale, të thërrasin qytetarët, sa m2 të djegur? Sa janë orenditë e dëmtuara...Ju thoni 50

Dokumentacioni të vijë i plotë, qytetarët të kenë dijeni. Besoj për dëmshpërblimin nuk e dinë sa është vlera. Kanë firmosur për banesën e djegur.

Z.Illir Aliaj – Ky lloj vlerësimi bëhet nga komisioni...lexon...shikon çfarë është djegur...

Ata dëmshpërblehen në bazë të llojit të orendive që kanë.

Z.Aulon Spaho – Preventivat janë në rregull. Në komision nuk ka patur kundërshtime.

Procesverbali

Z.Atird Hoxha – Keni kontaktuar me qytetarët për sot dhe vlerën e dëmshpërblimit?

Z.Aulon Spaho – Jo.

Z.Ervis Moçka – Procesverbali i konstatimit...gjen procesverbal të forcave, pra të zjarrfikëses...Zjarrfikësja mban një procesverbal .Edhe institucioni i qarkut , është pjesë e procedurës. Pra, është zjarrfikësja dhe forcat e rendit . Gjithë vlera bëhet në bazë inicialesh, në bazë të monedhave në fuqi. Komisioni konstaton, komisioni vlerëson dhe po ti tërheqim këto 4 projektvendime, nuk do ndryshojë asgjë, pasi asnjë procesverbal nuk mund të ndryshojë. Por, do të doja që të vihej në dispozicion i gjithë dokumentacioni.

Z.Myzafer Elezi – Djegiet e banesave janë fatkeqësi . Drejtori kërkon çertifikatën e pronësisë.

-Drejtori i zjarrfikëses, të na japë një informacion në lidhje me gjendjen aktuale, problematikat dhe nevojat që ka Zjarrfikësja .

Ftoj të gjithë ti miratojmë këto projektvendime.

Z.Atird Hoxha – Propozimi për heqjen nga rendi i ditës, që të thirren qytetarët, të vijë procesverbalet.

Znj.Elpinqi Mërkuri – Kalojmë në miratim për zotin Petrit Izetaj .

Votohet.

Pro - 35 vota

Kundër – 10 vota

Abstenim – 0 vota

Miratohet.

Kalojmë në miratim për z.Besnik Çobo. Votohet.

Pro – 35 vota

Kundër – 10 vota

Abstenim – 0 vota

Miratohet

Votohet për zni.Anife Aliraj.

Pro – 35 vota

Kundër – 11 vota

Abstenim – 0 vota

Miratohet.

Votohet për zotin Gjergji Memaj.

Pro – 35 vota

Kundër 11 vota

Abstenim – 0 vota

Miratohet.

Znj. Alta Haluci – Për ata që do marrin dëmshpërblim ...Nuk mund të blihet asnjë pajisje....Jemi kundër këtij dëmshpërblimi, jo se, nuk duam të marrin dëmshpërblim qytetarët. Ishte vlerë qesharake.

Z. Ervis Moçka – Debati bëhet në mbledhjet e komisioneve. Ka qytetarë që kanë nevojë dhe për këto lekë.

Znj. Elca Bezhani – E thashë dhe më parë, e diskutuam. Mesatarja e dëmshpërblimit, ju drejtuam administratës që, këto kompensime të jenëAdministrata, 4% e buxhetit, është për këto raste fatkeqësish.

Z. Erëmal Arapi – Ne kërkuam transparencë dhe reflektim.

Z. Atird Hoxha – Të marrin më shumë.

Z. Ervis Moçka – Ti kalojmë këto se, këta kanë nevojë për këto lekë.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA VLORË
KËSHILLI I BASHKISË

Nr _____ prot

Vlorë, më ____ . ____ 2023

Procesverbal
Nr 11/7, datë 31.08.2023.

Znj.Elpinqi Mërkuri – Pika 9 e rendit të ditës, miratimi i projektvendimit “Për shtyrje të afatit të kontratës për administrimin dhe financimin e Shoqërisë “Flamurtari Football Club Sh.A”.

Z.Ervis Moçka – Është një propozim i grupit të këshilltarëve të Partisë Socialiste. Është një marrëveshje e miratuar në vitin 2014. Më pas në 2016, 2018 dhe në 2021 është shtyrë afati për 2 vjet . Ligji “Për sportin”, ka ndryshuar . Nuk është proceduar. Është një kërkesë nga Administratori i “Flamurtarit”. I ka mbaruar afati kësaj kontrate. Kërkesë e shoqërive TRK dhe ATLAS, financuesve, për shtyrjen e afatit të kontratës.

Pika 3 (sipas kontratës, administratori është përcaktuar....këshilli mbikqyrës, 3 anëtarë këshilli mbikqyrës dhe 1 nga këshilli dhe, ne propozojmë z.Endri Hyseni.

Ne kërkojmë shtyrjen e afatit derisa administrata të marrë kohën e duhur.

Z.Atird Hoxha – Pse nuk është kundërfirmosur nga ju , por nga ana e kryetarit të grupit, ashtu sikurse keni firmosur për klubin e “Oriku”-t, zoti kryetar.

-Është bërë kërkesë nga administratori ose financieri për shtyrje afati. Ne sot nuk e kemi këtë kërkesë, nga ana e tyre. Për shtyrjen e afatit i qëndrojmë kontratës së vitit 2014. Ligji në vitin 2021...administrata nuk ka filluar procedurat e privatizimit. Zoti Moçka thotë që, nuk kanë dalë aktet nënligjore...Pse për klubet e tjera kanë dalë . (Lexon...financimin ...si pjesë e çmimit të kapitalit ..) Në bilancin e QKB , në vitin 2011, nuk ka të përcaktuar këtë vlerë...Në moment, në këtë pikë , pikën 2 të kontratës, ky është i favorizuar. Bashkia Vlorë financimit të

Z.Illir Aliaj – Ka garanci për financimin që ka bërë. Në rast se e blen një tjetër, më shumë i fuqishëm ...

Z.Atird Hoxha – Hap garën. Pse shtyn kontratën. Flamurtari është i të gjithëve.

Në pikat 2,3 që vlejnjë për financuesin...Çdo 3 muaj duhet të kemi informacion , është pronë e qytetit të Vlorës. Kjo është një përsëritje e shëmtuar që prej 10 vjetësh. Pse duhet të shtyjme afatin e kontratës...Sot “Flamurtari “ ka 2,2miljon Dollarë ndaj të tretëve. Pse duhet të bëjmë shtyrje afati, kur ka kaq shumë borxhe. Për çfarë arsye këshilli bashkiak, ti shtyjë afatin këtij administratori me kaq shumë borxhe...sipas bilanceve. Nuk mund të vazhdojmë të shtyjme

kontratën, për një investim që ai bën, i rritet pikëzimi. Pra, në një kompani që të ketë 2,2 milion Dollarë borxhe. Unë mendoj që ky projektvendim, ka një sërë problematikash, e kanë zhytur në borxhe. Jemi në kompani të zhytur në borxhe.

Znj.Evis Allushi - Me cilësinë e kryetares së këshillit të bashkisë, në vitin 2014, kam firmosur kontratën. I qëndroj kësaj firme. Ne i kemi kursyer bashkisë 10 milion Euro.

Ne nuk i kemi paguar zotit Idrizi. Ti jemi mirënjohës, askush nuk është afruar deri tani. Është absurde si kërkesë, një pasqyrë financiare....Qarkullojnë fjalë, sikur do marrë stadiumin, etj... Janë fjalë të pabaza. Kur të privatizohet, do të jemi ne ata që do ta miratojmë. Ligji ka dalë, administrata nuk ka ndërmarrë procedurat e privatizimit. Administrata të përgatisë sa më shpejt procedurat për privatizim. Jemi në kushtet që nuk është bërë asgjë. I lihet detyrë administratës të fillojë procedurat e privatizimit, se do ti ngelet bashkisë. Deklaroj votën time pro. Ftoj të gjithë ta miratojmë.

Znj.Alta Haluci - Ne u konsultuam me specialistë, i tha Atirdi. Të gjithë e kemi parë Flamurtarin dhe që ti themi faleminderit zotit Idrizi..... Them për ata që e njohin Flamurtarin. Është gabim i madh që, Flamurtari është në atë gjendje dhe ti themi faleminderit zotit Idrizi, se s'ka marrë lekë ? Çfarë ka bërë ? S'po flas me shifra , por për gjënë më minimale.

Z.Gëzim Çapoj – Ky projektvendim, nuk do diskutuar shumë nga ne, se po s'ju shty afati i kontratës , ai humbet. Të mos e zgjasim. Ta miratojmë dhe pastaj të shohim , çfarë do të bëjë administrata.

Z.Sokol Kushta – Po flas për financimin. Duhet të shohim kontratën e parë. 4 vjet, jam i vetmi person që kam ngritur emergjencën për ta shitur, për të dalë nga kjo gjendje. Flamurtari, është i rrënuar. Nëqoftëse, ndonjë pikë apo nen nuk është vendosur, duhet të shohim klubet e tjerë si e kanë bërë. Ka qenë jo dashamirës, kryetari i kaluar.

Kam diskutuar gjithmonë për Flamurtarin, të shiten aksionet, jo asetet. Vllaznia ka qenë e fundit....Përsa i përket zotit Sinan , i ka hequr një barrë bashkisë. Them ta votojmë, ti japim kohë administratës për procedurat dhe, kryetari i bashkisë, është dashamirës. Të bëhemi të gjithë bashkë, si do dalë Flamurtari nga kjo gjendje. Të bëjmë shtyrjen., blerjen e aksioneve.

Z.Atird Hoxha – Të nxjerrë njoftim administrata, kush do ta financojë Flamurtarin.

Z.Sokol Kushta – Ta votojmë

Z.Ermal Dredha – Jo më kot, afati është 1 vit shtyrje e kontratës. Pra, dhe ne të marrim kohën tonë, ..

Pra, në bazët të ligjit, të shohim.Ka ardhur kërkesë nga Administratori i Flamurtarit. Dhe kjo, dhe më parë, ka qenë propozim nga këshilltarët, prandaj nuk e kam firmosur unë. Zoti Sinan , ka financuar. Ti japim vehtes 1 vit kohë, por Flamurtari mund të ketë ulje – ngritje. Procesi i privatizimit do të fillojë vitin tjetër. Dhe financiarisht, ka investuar, duke filluar që nga pagat...etj , nuk mundet bashkia. Do bëhet privatizimi i aksioneve. Ne si bashki, i japim kohë vehtes.

Z.Ervis Moçka – Qëllimi i projektvendimit. Ky projektvendim, lidhet dhe emocionalisht për

shumë në sallë. Qëllimi për këtë projektvendim, siç u citua ...por jo, një analizë financiare e financuesit, por do ishte një analizë...S'kallon një afat dhe është bërë një kërkesë. Prandaj, po bëhet shtyrja për 1 vit. Kemi dhe pikën 3., të merret me privatizimin, brenda këtij afati, ku financuesi, është i gatshëm të bëjë këto investime dhe financime, duke i hequr një barrë të madhe bashkisë. Gjatë kësaj kohe, administrata, pas kësaj mbledhje, le të fillojë procedurën. Ne si grup jemi dakort për miratimin e shtyrjes së afatit të kësaj kontrate.

Z.Atird Hoxha – Neni 94, i rregullores..(lexon, brenda 20 ditëve) Pika 5 e po këtij neni (lexon ...) Ju keni bërë një gjysmë procedurë. Pra, propozimi i kryetarit të grupit , i bëhej kryetarit të bashkisë...Keni bërë gjysmë procedurë...vitin 2021 subvencioni...Administratori, investimin që bën, në fund do ta faturojë për 10 vjeçar. Ka financuar 1,8 milion Dollarë, zoti Idrizi , në 10 vite dhe ka borxh 2,2 milion Dollarë ndaj të tretëve.

Z.Ermal Dredha – Po pagat ?

Znj.Financiere KL”Flamurtari “- I dëgjova diskutimet tuaja, por nuk është parë asnjë nga ju në ambjentet e Flamurtarit. Përsa i përket detyrimit, është i vërtetë, por që në zanafillë kemi pas detyrime kontraktuale, ku shumë lojtarë, na kanë hedhur në gjyq. Por nga gjyqet, gjithë kontratat janë pasqyruar, me pagat bruto...

Pagat mujore, mbi 50 milionë...

Znj.Elca Bezhani – Kur shqyrtojmë një projektvendim në komision, shqyrtojmë bazën ligjore.

Duke parë dhe ecurinë ndër vite të Flamurtarit..., Të gjithë e duam Flamurtarin. Të tregoheni shumë të kujdesshëm, në mënyrën kur etiketoni, sepse fjala do të na jepet të gjithëve, nuk duhet ta fyejmë njëri tjetrin. Komisioni i Ekonomisë e shqyrtoi problemin bazuar në ligj, për shtyrjen e afatit administratorit për 1 vit.Zoti Atird, theksoi dhe për projektvendimin për “Oriku”-n.

Janë dy gjëra. Në këtë rast është çështje administrimi, bazuar në Nenin 8,2 të ligjit Nr 139/2015; Neni 54, pika ...lexon..., pra shikojmë bazën ligjore.

Neni 33 për shfrytëzimin e terreneve sportive. Flitet dhe për financim. Bashkia nuk harxhon “zero” lekë. Pra, kjo kontratë të shtyhet 1 vit që, dhe administrata të ketë kohë të fillojë shitjen e aksioneve.

Aktet nënligjore, nuk kanë dalë. Zoti Gunbardhi diskutoi gjatë, i cili propozoi të vinte Administratori, të na japë një informacion në lidhje me gjendjen, në të cilën ndodhet Flamurtari.

Z.Erëmal Arapi – Jeni në kundërshtim me procedurat. Pra, zoti Moçka, duhet t’ia kalojë kryetarit dhe, kryetari brenda 20 ditëve ...Këtu shkelen procedurat, vijnë materialet pa protokol.

Z.Klodian Xhyheri - Flamurtari ka rezultate shumë të këqia në lojë, por dhe shumë borxhe. Me një financim modest dhe bashkia mund ta mbante në këto kushte. Pse do ta zgjasim këtë afat ?

Z.Ervis Moçka – U diskutua procedura, si u firmos, por nuk u dhe një zgjidhje. Çfarë zgjidhje jepni ju sot ?

Nuk është shmangur procedura , i kaloi për mendim administratës, por çfarë zgjidhje i japim? Ta lëmë pa rregjistruar ?

Zgjidhja është ta shtyjmë afatin 1 vit dhe, pastaj procedurat për privatizim nga administrata.

Z.Ermal Dredha – Ne duam kohë për të nisur procedurat e privatizimit.

Z.Daut Zëraj - Nëse flasim për këtë procedurë, këshilli bashkiak, është në dijeni. Propozimi është parë, nuk ka efekte financiare. Bashkia nuk miraton fonde.

Z.Atird Hoxha – Po kur ta privatizoni...

Z.Daut Zëraj – Ka vetëm detyrime juridike, jo financiare, nuk ndikon në buxhet.

Z.Atird Hoxha – Hapni bilancin, keni efekte financiare..I ka të kapitalizuara.

Z.Ilir Aliaj – Nëqoftëse, del një qytetar që e blen...Zoti Sinan në kontratë, shiko dhe “3,3,2”, i ka firmosur, lexoje.

Z. Geron Gunbardhi – Në Komisionin e Ekonomisë, e diskutuam. Unë personalisht kërkova një informacion, pse Flamurtari është në këtë gjendje...Por, me Sokol Kushtën, krenohemi.

Të bëni procedurat ligjore..., Pse Flamurtari është në këtë gjendje ? Është turp sot këtu , nuk njohim lojtarët, të zëmë në gojë Flamurtarin. Çdo gjë varet nga aksionet, nga rezultatet e klubit.

Gjithë investimet, kur ka firmosur bashkia , për terrenet, fushat sportive, a është bërë ndonjë investim për tualete. Zonja të na japë një informacion për Flamurtarin, gjendjen e tij.

Z.Grigor Dede – Duhet të ketë debate dhe diskutime. Këtu kemi një shtyrje të afatit të kontratës.

Thuhet që zotëria do të nxjerrë fatura financiare, ka ligj për financat. Do na dalin këto financime, do bëhet analizë financiare...,përsa u përket borxheve, do ishte bllokuar. Ishin 15 milion të kursyera për 9 vjet.Tek cilësia sportive

Znj.Elpinqi Mërkuri – E kalojmë në votim.

Pro – 32 vota

Kundër – 5 vota

Abstenim - 3 vota

Miratohet.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA VLORË
KËSHILLI I BASHKISË

Nr _____ prot

Vlorë, më ____ . ____ 2023

Procesverbal
Nr 11/8, datë 31.08.2023.

Znj.Elpinqi Mërkuri – Kalojmë tek pika 10 e rendit të ditës, në miratimin e projektvendimit “Për një rishpërndarje të fondit të shpenzimeve të parashikuara në VKB Nr 1, datë 18.01.2023 “Për Buxhetin e Bashkisë për vitin 2023, i ndryshuar” .

Një relacion nga drejtoria përkatëse.

Z.Hiqmet Haxhaj – KF”Oriku” është krijuar që në vitin 2013, në bashkinë Orikum, dhe më pas në Bashkinë Vlorë. 100% e kapitalit Bashkia Vlorë, është financuar nga Bashkia Vlorë. Në vitin 2022, s’pati mundësi për financime bashkia . Ka ardhur kërkesë nga Klubi “Oriku” për financim. Administrata e bashkisë, bazuar në ligj, bën financimin e klubit. Mendojmë ta financojmë për periudhën 4-mujore, për ti dhënë kohë vehtes dhe klubit, për të bërë hapat e tjerë ligjore. S’ka efekte financiare, do të financohet nga kursimet për t’ia kaluar si subvencion, shumën prej 50 milion.

Z.Arsen Belaj – KF”Oriku”, është krijuar në vitin 2008. Kam qenë anëtar i bordit dhe këshillit mbikqyrës. Jam sportëdashës dhe futbollist. Jam mbështetës i tij, por nuk jam dakort që “Oriku” të financohet vetëm për 4 muaj. Ka shumë shpenzime. Shuma prej 50 milionë është shumë e vogël. Mbas 4 muajsh, nëse zotit Idrizi i shtohet kontrata për 1 vit, mendoj që në buxhetin e vitit 2024, le të financohet dhe më vonë, derisa të fillojë procedurat e privatizimit. Atje është një akademi futbollit, është i vetmi gjë. Shtyheni afatin për 1 vit, deri në shtatorin tjetër , financimin dhe, vlera është shumë e vogël.

Z.Ermal Dredha – Folëm në parim. Është për tu parë projekt buxheti i vitit të ardhshëm. Nuk ka tendencë që, kjo për 4 muaj, pastaj të shohim ç’të bëhet. Do të shohim, ka shumë impakt social. Duhet të fillonin procedurat e privatizimit. Jemi munduar , brenda buxhetit me këtë shumë.

Z.Sokol Kushta – Kur kemi diskutuar për atë zonë, 50 milion është gabim, duhet të ishte më shumë. Zoti Gëzim dhe zoti Muharrem, kanë bërë shumë. Këta zotërinj, të plotësojnë dokumentacionin, të kthehet në privat. S’kam asgjë, e falënderojmë edhe 50 milojn, por s’jam dakort për lëmoshë.

Znj.Elca Bezhani – Edhe ky projektvendim u diskutua në mbledhjen e komisionit të ekonomisë. Vlera prej 5 milion lëkësh të reja, kërkesë e KF”Oriku” për financim , nuk plotësohet 100% nga bashkia, por dhe nga sponsora.

Po diskutojmë për buxhetin e vitit të ardhshëm. Zoti Kryetar i bashkisë, është dhe një nga premtimet tuaja elektorale dhe unë propozoj për një këshill konsultativ, të kishim persona kontabilistë, financiarë nga grupet e interesit. Paketa fiskale e Bashkisë Vlorë, është goxha e vjetër. Ky grup konsultativ mund të kontribuojë në vlerësimin e kësaj pakete.

Znj.Elpinijë Mërkuri – E kalojmë në votim.

Pro – 37 vota

Kundër – 0 vota

Abstenim – 1 votë

Miratohet.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA VLORË
KËSHILLI I BASHKISË

Nr _____ prot

Vlorë, më ____ . ____ 2023

Procesverbal
Nr 11/9, datë 31.08.2023.

Znj.Elpiniqi Mërkuri – Pika 11 e rendit të ditës, miratimi i projektvendimit “Mbi përcaktimin e kriterëve për zgjedhjen e anëtarëve të kryesisë dhe kryetarit të fshatrave në juridiksionin e Bashkisë Vlorë “.

Z.Endri Hyseni – Në komisionin juridik, u diskutua ky projektvendim për të qenë sa më funksionalë, strukturat komunitare në fshat.

Tre kriteret bazë:

1-Banim në fshat

2-Të ketë përfunduar shkollën e mesme

3-Mos të jetë dënuar nga gjykata.

Përfundimisht, nëqoftëse, do të ketë ndonjë gjë tjetër/kriter... dhe kërkoj ta miratojmë këtë projektvendim.

Znj.Frosina Qyrdeti – Dhe në komisionin e mandateve dhe rregullores, u diskutuan kriteret dhe ramë dakort.. Vetëm tek pika “a”, të shtohet, në fshatin ku kandidon.

Z.Elpiniqi Mërkuri – Kalojmë në votim.

Pro – 38 vota

Kundër – 0 vota

Abstenim – 0 vota

Miratohet.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA VLORË
KËSHILLI I BASHKISË

Nr _____ prot

Vlorë, më ____ . ____ 2023

Procesverbal

Nr 11/10, datë 31.08.2023.

Znj.Elpinqi Mërkuri – Pika 12 e rendit të ditës, miratimi i projektvendimit “Mbi përcaktimin e numrit të anëtarëve të kryesisë së fshatrave, ë anëtarëve të këshillit të bashkisë , të cilët do të mbikqyrin zgjedhjen e kryesisë së fshatrave si dhe, datat e zhvillimit të zgjedhjeve në çdo fshat “
Z.Daut Zëraj – Sipas rregullores së funksionimit dhe strukturave në fshat..fshatrat me mbi 2000 banorë, janë komisionet me 5 anëtarë, në fshatrat me më pak se 2000 banorë, komisioni me 3 anëtarë. Është këshilli bashkiak që mbikqyr këtë proces. Emrat që kemi vendosur, 3 pozitivë + 2 opozitë...Por mund të bëni propozimet tuaja.

Z.Illir Aliaj – Nëqoftëse, grupi tjetër...

Z.Daut Zëraj – Kështu e menduam. Bërja e listës nuk përjashton asnjërin, nuk është komisioni vendimmarrës. Është në mënyrë rastësore, janë gjithësej 36 fshatra.

Znj.Elpinqi Mërkuri – Sillini propozimet.

Z.Daut Zëraj – Në çdo fshat keni përfaqësues.

Z.Klodian Xhyheri – Shumë pak nga” Bashkë Fitojmë “ Ligji Nr 139/2015 , neni 70...lexon..Kreysia e fshatit, pika...ku në mbledhje, duhet të marrë pjesë më votim gjysmasepse, ne nuk kemi 50+1 të votuesve , nuk do ti bëjmë dot. Do zbatojmë ligjin 1 për 1.

Z.Ervis Moçka – Ndarja e emrave, propozimi i kryetarëve të grupeve. Diskutoni, por nuk sillni emrat.

Znj.Elpinqi Mërkuri – Votohet.

Pro – 37 vota

Kundër – 2 vota

Abstenim – 0

Miratohet.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA VLORË
KËSHILLI I BASHKISË

Nr _____ prot

Vlorë, më ____ . ____ 2023

Procesverbal
Nr 11/11, datë 31.08.2023.

Znj.Elpinqi Mërkuri – Pika 13 e rendit të ditës, miratimi i projektvendimit “Për disa ndryshime në VKB Nr 54, datë 21.07.2023 “Për miratimin e komisioneve të përhershëm të Këshillit Bashkiak Vlorë”.

Z.Ervis Moçka – Pika “2” e këtij projektvendimi, nuk është e nevojshme të bëhet, sepse është pasqyruar në mbledhjen e kaluar.

Znj.Elpinqi Mërkuri – E kalojmë në votim.

Pro -38 vota

Kundër – 0 vota

Abstenim – 0 vota

Miratohet .



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA VLORË
KËSHILLI I BASHKISË

Nr _____ prot

Vlorë, më ____ . ____ 2023

Procesverbal
Nr 11/12, datë 31.08.2023.

Znj.Elpinqi Mërkuri – Kalojmë në pikën 14 të rendit të ditës, në miratimin e projektvendimit “Për miratimin e zëvendëskryetarëve dhe anëtarëve zëvendësues të komisioneve të përhershëm të Këshillit të Bashkisë Vlorë”.

Z.Erëmal Arapi – Zoti Daut, duhet të konsultohet me kryetarët e grupeve.

Z.Daut Zëraj – Ju bëni ndryshimet tuaja. Unë i kërkoja, si solli njeri.

Znj.Elpinqi Mërkuri – I sillni sygjerimet tuaja. I ndryshojmë.

Z.Daut Zëraj – Bëni propozimet.

Znj.Elpinqi Mërkuri – Kalojmë në votim.

Pro – 39 vota

Kundër – 0 vota

Abstenim – 0 vota

Miratohet.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA VLORË
KËSHILLI I BASHKISË

Nr _____ prot

Vlorë, më ____ . ____ 2023

Procesverbal

Nr 11/13, datë 31.08.2023.

Znj.Elpiniaqi Mërkuri – Kalojmë tek pika , “Të ndryshme”.

Z.Atird Hoxha – Në vendim këshilli bashkiak në mbledhjen e kaluar, diskutuam për shtimin e numrit të punonjësve në varrezat publike. Nuk e kuptoj, kam disa pamje, grumbuj mbetjesh. Pra, për mua është e turpshme, kërkohet dhe rritje e numrit të punonjësve...por , të punohet.

-Kam informacion, se janë punësuar 4 persona nga një familje..Nuk bëhet me njohje, duhet punuar.

- Në fshatin Trevllazër, në 2 lagje, problem uji i pijshëm.

-Mbeturinat në zonën bregdetare. Nuk pastrohet vija bregdetare. Koshat nuk zbrazen.

-Ujrat e zeza në vijën bregdetare. Ku derdhen mbetjet.

-Makinat në rrugët e qytetit të parkuara në vite.Prapronarët le ti heqin...të lirohen hapsirat publike.

-Çfarë leje ka godina në qendër të qytetit?

-Fasadat që po investohet nga Gjyqi i Vjetër deri tek Shkolla e Muzikës. Priten pemët në muajin gusht nga Gjyqi i Vjetër deri tek Shkolla “Naim Frashëri “

-Në lidhje me ligjshmërinë, pse e ka sjellë prefekti , pasi për Bashkinë Himarë nuk është shprehur.

Z.Ervis Moçka – E mirëkuptoj Kryetarin e bashkisë, që mund të lëvizë, por jo administratën që mungon për dëgjimin e shqetësimevetë qytetarëve nga këshilltarët dhe, llogaridhënien dhe zgjidhjen e tyre. E kërkoj nga Ju zonja Kryetare.

Znj.Edlira Kapllanaj – Duhet të respektohet radha. Një kërkesë nga banorët e lagjes Çole dhe Kume, stacion urban për të shkuar në lungomare.

-Nga disa banorë rom dhe egjyptian , në Lllakatund, ndërtesa për rikonstrukcion.

-Po afron viti i ri shkollor. Të shihet mundësia e kontrollit të detyrueshëm dentar në shkolla.

-Dizinfektimi i kontenierëve dhe pastrimi i plehrave.

-Kaos tjetër, parkimet në qytet.Të mendohet nga drejtoria e urbanistikës për parkimet, trafikun

-Në mbledhjen e muajit shtator , të vijë dhe të trajtohen banesat sociale me kosto të ulët.
Z.Simo Petromilo – Meqenëse, administrata nuk është këtu, të shtyjmë pikën të ndryshme.
Znj.Elpinqi Mërkuri – Përsa i përket radhës, unë zbatoj një rend, e marrin fjalën të gjithë.
Faleminderit për takimin e sotëm.